



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 131 Prot

Tiranë, më 23.02, 2015

VENDIM Nr. 16 datë 18.02.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2, të datës 18.02.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit “Godinë shërbimi dhe parkim 7 kat, në rrugën "Prokop Meksi", Durrës, zona arkeologjike "B", paraqitur nga subjekti " RAJFI" sh.p.k.,

VENDOSI:

- I. Të mos miratojë kërkesën për miratim të projektit “Godinë shërbimi dhe parkim 7 kat, në rrugën "Prokop Meksi", Durrës, zona arkeologjike "B", paraqitur nga subjekti " RAJFI" sh.p.k., pasi pas gjurmimit-shpëtimit të kryer në truallin pranë, ku është ndërtuar një objekti ri 2, 3 dhe 6 kat me dy kat nëntokë, rezulton se janë zbuluar objekte të rëndësishme arkeologjike të periudhave të ndryshme dhe një sistem infrastrukturor (rrugë dhe kanalizime), i cili sipas drejtimit të rrjetit rrugor dëshmon për vijimësinë edhe në truallin ku kërkohet të ndërtohet.
- II. Në vijim, në kuadër të zbulimeve të rëndësishme arkeologjike të gjetura në qytetin e Durrësit, është e nevojshme të paraqitet nga Instituti i Arkeologjisë në një periudhë sa më të afërt, zonifikimi i ri arkeologjik i qytetit të Durrësit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO